



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA BERAT
DREJTORIA JURIDIKE

Nr. _____ Prot

Date ____/____/2024

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës - shërbime

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROCEDURËS:

Mbikqyrje punimesh për objektin “Ndërtim i Shkollës 9-Vjecare "22 Tetori" dhe parkim nentokesor”

Kodi përkatës në fjalorin e përbashkët të prokurimit **FPP71247000-1 – mbikqyrja e punës së ndërtimit.** ____

Vlera e fondit limit: 3 748 963.3 (tre milion e shtatëqinde e dyzete e tete mijë e nentëqinde e gjashtedhjetë e tre presje tre) leke pa Tvsh,

VKM nr 354 ,date 11.05.2016 , “Miratimi i manualit të tarifave për shërbime në planifikim territorri , projektim , mbikqyrje dhe kolaudim”

Në zbatim të ligjit 8402 “Për disiplinimin e punimeve të ndërtimit ,udhëzimit të Keshillit Ministrave nr 3 ,date 15.02.2001,udhëzimit nr 1 date 22.02.2005,udhëzimit nr 1 date 16.06.2011 “Për mbikqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit

Kualifikohet oferta që në zbatim të udhëzimit të APP –se oferta e cila është më e vogël se vlera maksimale dhe ajo mbi vlerën minimale përfshi dhe vlerën minimale të tarifave të VKM nr 354 ,date 11.05.2016 , “Miratimi i manualit të tarifave për shërbime në planifikim territorri , projektim , mbikqyrje dhe kolaudim”

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor Bashkia Berat ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

Adresa: Blvd. “Republika 2”, Berat 5001. Shqipëri, Tel /00355(0) 2 32 34 935,

Website : www.bashkiaberat.gov.al, Email : info@bashkiaberat.gov.al



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA BERAT
DREJTORIA JURIDIKE

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

- a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9
- b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1. Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare 2021 ,2022,2023 ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 40 % e vleres se fondit limit të kontrates që po prokurohet.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë: Lloji i procedure është ”E Hapur e Thjeshtuar Shërbime”, përcaktimi i vleres se kerkuar eshte bere ne mbeshtetje te VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” ku përcaktohet se: 40% të vlerës së parashikuar të kontratës në procedurat e prokurimit dhe ne procedurat e prokurimit E Hapur e Thjeshtuar Shërbime si dhe në Ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, VKM nr. 922 datë 29.12.2014 "Për deklarimin e detyrueshëm të deklaratave tatimore dhe të dokumenteve të tjera tatimore, vetëm nëpërmjet forms elektronike", si dhe në Udhëzimin e Ministrisë të Financave nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar,

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar eshte bere ne mbeshtetje VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” ku përcaktohet se: ” Autoriteti/enti kontraktor, për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, kërkon kopje të deklaratave të xhiros vjetore të realizuar nga operatori ekonomik dhe, sipas rastit të xhiros që mbulon kontrata, për një periudhë maksimumi deri në 3 (tre) vitet e fundit financiare”.

2.2.2. Kopje të vërtetuara të bilanceve vjetore të tre viteve të fundit 2021 , 2022,2023) të paraqitur pranë autoriteteve përkatëse tatimore , të konfirmuara nga ky autoritet që te

Adresa: Blvd. “Republika 2”, Berat 5001. Shqipëri, Tel /00355(0) 2 32 34 935,

Website : www.bashkiaberat.gov.al, Email : info@bashkiaberat.gov.al



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA BERAT
DREJTORIA JURIDIKE

tregojne raportet midis aktivitet dhe pasivitet . Shenim: Ne respektim te VKM nr. 285, date 19.05.2021 ” Per miratimin e rregullave te prokurimit publik”, neni 43, pika 4, kjo kerkese do te konsiderohet e permbyshur nqs dy bilancet e njepasnjeshme nuk kane raport negativ ndermjet aktivitet dhe pasivitet.

Autoriteti Kontraktor rezervon te drejten te verifikojte vertetesine e informacionit te paraqitur ne zbatim te Ligjit nr.162/2020 date 23.12.2020 “Per Prokurimin Publik” dhe VKM nr. 285, date 19.05.2021 ” Per miratimin e rregullave te prokurimit publik”.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenit 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, si dhe kërkesave të ligjit Nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”. Referuar në nenin 29 të Ligjit Nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat tatimore: “Çdo tatimpagues përgatit deklaratën vjetore të të ardhurave të tatueshme në formën e përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji. Tatimpaguesit paraqesin deklaratën vjetore në organet tatimore brenda datës 31 mars të vitit pasardhës, duke paraqitur në të njëjtën kohë bilancin kontabël, së bashku me anekset e tij, si dhe çdo të dhënë tjetër të përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji.

*Ndërsa shoqërimi me Akt Ekspertizen e Ekspertit Kontabel te Autorizuar, është bërë duke iu referuar parashikimit në nenit 41 shkronja c” të Ligjit nr. 1009/2009: “Personat juridikë që detyrohen për auditimin ligjor të pasqyrave financiare detyrohen të kryejnë auditimin ligjor të pasqyrave financiare vjetore, përpara publikim të tyre, nga ekspertë kontabël ose shoqëri audituese: "c) shoqëritë me përgjegjësi të kufizuar, të cilat zbatojnë për raportimin financiar standardet kombëtare të kontabilitetit, kur, në mbyllje të periudhës kontabël, për dy vite radhazi, tejkalojnë **dy prej tre treguesve të mëposhtëm: i) totali i aktiveve të bilancit, në mbyllje të periudhës kontabël përkatëse, arrin ose e kalon shumën prej 50 milionë lekësh; ii) shuma e të ardhurave nga veprimtaria ekonomike (qarkullimi) në atë periudhë kontabël arrin ose e kalon shumën prej 100 milionë lekësh; iii) ka, mesatarisht, 30 të punësuar gjatë periudhës kontabël”.***

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1 Për të provuar përvojën e mëparshme ofertuesi duhet të dorëzojë:

Përvojë e suksesshme në realizimin e të paktën:

Adresa: Blvd. “Republika 2”, Berat 5001. Shqipëri, Tel /00355(0) 2 32 34 935,

Website : www.bashkiaberat.gov.al, Email : info@bashkiaberat.gov.al



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA BERAT
DREJTORIA JURIDIKE

2.3.1. Operatori Ekonomik duhet të paraqesë shërbime të ngjashme me objektin e prokurimit me vlerë jo me te vogel se 20% e vlerës së fondit limit që prokurohet , të realizuara gjatë tri viteve të fundit, nga data e njoftimit të kontratës së shpallur.

a) Kur kontrata eshte realizuar me institucione shtetërore, ofertuesi duhet të paraqesë kontraten e nenshkruar, vërtetim per realizimin me sukses nga institucioni me te cilin është lidhur kontrata te shoqeruar me faturen tatimore.

b) Kur kontratat jane te realizuara me subjekte private ofertuesi duhet te paraqese kontraten e nenshkruar dhe faturat tatimore ku te jene shënuar datat, shumat dhe shërbimet e realizuara

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 3 (ose në rastin e procedurave të thjeshtuara në nenin 55, pika 4/b), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që shërbimet e mëparshme të ngjashme të jenë ne vlerën jo më pak se 20 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

2.3.5 Licensa profesionale të shoqërisë (e vlefshme) për Mbikeqyrje dhe Kolaudim punimesh zbatimi ku të përfshihen kategorite:

PUNIME TË PËRGJITHSHME NDËRTIMI

Për punimet e përgjithshme të ndërtimit:

- N.P - 1 Punime gjermimi në tokë;
- N.P - 2 Ndërtime civile e industriale;
- N.P-5 Punime nëntokësore, ura e vepra arti

Për punimet speciale të ndërtimit:

- N.S.-1 Punime per prishjen e ndertimeve
- N.S - 2 Impiante hidrosanitare, kuzhina, lavanteri, mirëmbajtja e tyre;
- N.S-3 Impiante ngritese dhe transportues (ashensore, shkalle levizese, transportues)
- N.S - 4 Punime rifiniture të muraturës dhe të lidhura me to, rifiniture me materiale druri, plastik, metalik dhe xhami dhe rifiniture të natyrës teknike ndërtues;
- N.S-9 Punime strukturore speciale
- N.S - 12 Impiante teknologjike, termike dhe të kondicionimit;

Adresa: Blvd. “Republika 2”, Berat 5001. Shqipëri, Tel /00355(0) 2 32 34 935,

Website : www.bashkiaberat.gov.al, Email : info@bashkiaberat.gov.al



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA BERAT
DREJTORIA JURIDIKE

- N.S - 13 Impiante dhe linja telefonie dhe telekomunikacioni;
- N.S - 14 Impiante të brendshme elektrike, telefonike, radiotelefoni TV.
- NS - 18 Punime topogjeodezike

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 41, pika 4, gërma a,) të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, si dhe *vendimin nr.759, datë 12.11.2014 të Këshillit të Ministrave, “Për licencimin profesional të individëve dhe subjekteve juridike që do të ushtrojnë veprimtari në fushën e studimit e të projektimit në ndërtim dhe mbikqyrjes e koaludimit të punimeve të zbatimit në ndërtim”, ndryshuar me VKM-në nr.943 datë 28.12.2016” (shënim- përcaktoni aktin ligjor ose nënligjor specifik dhe nenin përkatës, që parashikon licencimin e subjekteve, në lidhje me veprimtarinë përkatëse për realizimin e shërbimeve objekt kontrate).*

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se disponojnë licencat profesionale që parashikohen nga legjislacioni në fuqi për kryerjen e shërbimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente

Meqenese kemi te bejme me Mbikqyrjen e punimeve ne zbatim argumentojme se Kategorite e mesiperme jane percaktuar ne perputhje me zërat e punimeve që parashikohen të kryhen në preventivin e punimeve të zbatimit per Objektin Ndertim i Shkolles 9-vjecare “22 Tetori”.

2.3.6 Operatorët ekonomikë pjesëmarrës, për realizimin e punimeve objekt kontrate, duhet të disponojnë personelin kryesor, drejtues teknik në licencën e shoqërisë, ose me kontrata sherbimi si më poshtë:

- Inxhinier Ndërtimi 1 (nje)
- Inxhinier Elektrik 1 (një)
- Inxhinier Topograf/Gjeodet/Markshajder 1 (një)

-Operatorët ekonomikë pjesëmarrës, për realizimin e punimeve objekt kontrate, duhet të disponojnë personelin ne liste pagesa ose , ose me kontrata sherbimi si më poshtë:

Arkitekt 1 (një)

Inxhinier Hidroteknik 1 (një)

Inxhinier Mekanik 1 (një)

Për këtë operatorët ekonomikë duhet të paraqesin :

Adresa: Blvd. “Republika 2”, Berat 5001. Shqipëri, Tel /00355(0) 2 32 34 935,

Website : www.bashkiaberat.gov.al, Email : info@bashkiaberat.gov.al



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA BERAT
DREJTORIA JURIDIKE

- Kontratë pune, Diplomën Universitare, Licence profesionale dhe Cv si dhe te figurojne ne listepagesen e shoqërisë per periudhen e kerkuar muajin e fundit .

Në çdo rast, Autoriteti Kontraktor ka të drejtë të bëjë verifikime lidhur me deklarinimin e OE, në funksion të përmbushjes së këtij kriteri.

2.3.7 Operatorët ekonomik ofertues duhet të paraqesin dokumentacion qe disponojne nje inxhinier per Restaurime dhe monumente kulture te pajisur me diplomen perkatese.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 39, pika 6/a, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” si dhe bazuar ne Ligjin Nr. 27/2018 PËR TRASHËGIMINË KULTURORE DHE MUZETË .

Duke qene se Berati eshte qytet muze, zona në të cilën do të kryhet investimi është zona e qendrës së qytetit ku zhvillohet pjesa më e madhe e jetës administrative, sociale e kulturore e qytetit dhe e gjithë bashkisë Berat, per te ndjekur dhe mbikqyrur te gjithe elementet e trashegimise kulturore duke perfshire monumentet si xhami dhe kiske , te cilat ndodhen ngjitur me objektin e prokurimit. Gjithashtu , zona ne te cilen do te realizohet projekti eshte rehabilituar ne perputhje me elementet e trashegimise kulturore te qytetit te Beratit.

Për këtë operatorët ekonomikë duhet të paraqesin :

- Kontratë pune / kontrate sherbimi dhe Diplomën

Shënim: Kjo kërkesë përmbushet nëpërmjet plotësimit dhe paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8 të DST.

Dokumentacioni provues do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë autoritetit kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse do të jetë nevoja për tu kërkuar sqarime nga AK.

personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. Konkretisht:

Njesia e prokurimit per vendosjen e stafit i eshte referuar Termave te references, gjithashtu argumentojme se zgjedhja e stafit të mbikqyrjes është bazuar në punimet respektive të përfshira në projekt preventivin e objektit

a) Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e punimeve objekt kontrate duhet të disponojë fuqi punëtore prej minimalisht 7(shtate) persona. Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë disponimin e numrit minimal të punonjësve në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit.

Për të dëshmuar përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të paraqesë:

Adresa: Blvd. “Republika 2”, Berat 5001. Shqipëri, Tel /00355(0) 2 32 34 935,

Website : www.bashkiaberat.gov.al, Email : info@bashkiaberat.gov.al



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA BERAT
DREJTORIA JURIDIKE

a) Vërtetim të lëshuar nga administrata tatimore shoqëruar me listëpagesat sipas formatit që kërkohet nga legjislacionin tatimor për (muaji i fundit)

b) Listëpagesat e punonjësve sipas formatit që kërkohet nga legjislacioni në fuqi për (muaji i fundit)

Ky kriter përmbushet nepermjet paraqitjes nga Operatorët Ekonomik të Formularit Përmbledhës të Vetdeklarimit, sipas shtojcës nr. 8 të DST-ve.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4/c, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë fuqinë punëtore të të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

Operatorët ekonomikë duhet të vërtetojnë se e zhvillojnë aktivitetin e tij në fushën objekt prokurimi në përputhje me standardet e menaxhimit të cilësisë, të shëndetit e sigurisë në punë dhe menaxhimit e sigurisë së informacionit. Për këtë duhet të paraqesin certifikatat e mëposhtme :

- ISO 9001:2015 (Sistemi i Menaxhimit të Cilësisë e vlefshme), ose ekuivalent
- ISO 45001-2018 (Sistemi i Menaxhimit dhe Sigurisë në Punë e vlefshme) ose, ose ekuivalentet
- ISO 14001-2015 (Sistemi i Menaxhimit Mjedisor e vlefshme), ose ekuivalent
- PAS 99-2012 (Sistemi i Integruar i Menaxhimit e vlefshme), ose ekuivalent
- ISO 3834-2:2021 – Standard për Kerkesat e Cilësisë për Saldimin e Materialeve Metalike **ose ekuivalent**
-

Argumentimi: Kerkesat e mesiperme janë vendosur bazuar në Nenin 79, pika 1 të Ligjit Nr. 162/2020, “Për prokurimin publik”, sipas të cilit: “Autoriteti ose enti kontraktor për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kerkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë”, si dhe në zbatim të Neni 44, pika 1 dhe pika 3 të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, ku përcaktohet se: “Autoriteti/enti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kerkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi

Adresa: Blvd. “Republika 2”, Berat 5001. Shqipëri, Tel /00355(0) 2 32 34 935,

Website : www.bashkiaberat.gov.al, Email : info@bashkiaberat.gov.al



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA BERAT
DREJTORIA JURIDIKE

kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lidhura ngushtësisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit” Çertifikatat e cilesise jane bazuar ne perputhje me objektin e zbatimit qe do te mbikqyret dhe jane ne perputhje me natyren dhe objektin e kontrates qe prokurohet.

II. Argumentimi i specifikimeve teknike/termave te references • Termat e References

- Fondi Limit i perlllogaritur per kete procedure eshte hartuar nga specialist te urbanistikes ne baze te V.K.M nr.354 date 11.05.2016 ”Për miratimin e manualit të tarifave për shërbime në planifikimin të territorit, projektim, mbikeqyrje dhe kolaudim”., dhe jane marre ne konsiderate te tere elementet perberes te sherbimeve te domosdoshme per ekzekutimin e kontrates.

Njesia e Prokurimit

Specialist i fushes(Ing)

Jurist

Ekonomist

Meleqe Spahiu

Fjoralda Arapi

Ardisa Zhuka

TITULLARI I AUTORITETIT KONTRAKTOR

Ervin DEMO

Adresa: Blvd. “Republika 2”, Berat 5001. Shqipëri, Tel /00355(0) 2 32 34 935,

Website : www.bashkiaberat.gov.al, Email : info@bashkiaberat.gov.al